

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - Shërbim

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM INTERNETI LINJA PRIMARE”

VLERA E FONDIT LIMIT: 21,773,156 (njëzet e një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) **Lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Identitek” Sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 9001:2015 (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 27001:2022 (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 20000-1:2018 (ose të përditësuar) e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë BS PAS 99-1:2012 (ose të përditësuar) e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 45001:2018 (ose të përditësuar) e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjisacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, e ndryshuar, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të

shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

- b. Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruar në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqes Autorizim të Përgjithshëm nga AKEP për secilin nga shërbimet e ofruara si dhe të mbulojë të gjithë territorin e Shqipërisë, të cilat duhet të jenë të vlefshme.

Argumentim: Për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, Operatori Ekonomik duhet ta vertetojë duke dorëzuar Autorizimin e Përgjithshëm nga AKEP që përbën kuadrin ligjor, të përcaktuar nga ligji nr. 9918 dhe rregullat e nxjerra nga AKEP-i, në zbatim të tij, për të siguruar të drejtat për ofrimin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke vendosur edhe detyrime specifike, të cilat mund të zbatohen ndaj të gjitha ose ndaj disa prej rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike.

3. Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë **minimalisht 20 (njezet)** persona të punësuar, të cilët do të kryejnë shërbimin instalimit, konfigurimit dhe mirëmbajtjen e shërbimit, të diplomuar në fushën e Telekomunikacionit, Elektronikë, Informatike, Teknologji Informacioni, Elektrike, ose ekuivalente, në profilet sipas tabelës si mëposhtme:

Nr.	Stafi	Nr.
1.	Punonjës të certifikuar në menaxhimin e mirëmbajtjes dhe SLA (ITIL) ose ekuivalent	1 (një)
2.	Punonjës të certifikuar si Arkitekt Cybersecurity	1 (një)
3.	Punonjës të certifikuar për MTCNA ose ekuivalente	2 (dy)
4.	Punonjës të certifikuar për MTCSE ose ekuivalente	2 (dy)
5.	Punonjës të certifikuar për MTCRE ose ekuivalente	2 (dy)
6.	Punonjës të pajisur me certifikate mbi sigurimin teknik si Teknik Fibre	5 (pesë)
7.	Punonjës të tjerë	7 (shtatë)
	Totali i punonjësve (minimalisht)	20 (njezet)

- Për punonjësit me nr. rendor 1,2,3,4,5,6 (sipas tabelës së mësipërme), OE duhet të paraqes:
- Kontratë pune individuale;
 - Diplomë përkatëse;
 - Çertifikata kualifikimi përkatëse.
 - Stafi që do të angazhohet për realizimin me sukses të kontratës, duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimsht deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale të lëshuar nga e - albania.
- Për punonjësit e përcaktuar në nr. rendor 7 (sipas tabelës së mësipërme), te paraqitet:
- Kontratë pune individuale;
 - Diplomë përkatëse;
 - Çertifikata kualifikimi (nëse disponojnë).

Stafi qe do te deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates. Rastet e deklaratave te rreme, do te konsiderohen kushte per skualifikim.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në numrin e zyrave, konkretisht 115 zyra aplikimi të cilat shtrihen në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që kanë nevojë për pajisjen dhe mbulimin me shërbim interneti. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

4. Operatori ekonomik duhet të deklaroj se do të ofrojë shërbimin “Help Desk” 24/7. Shërbimi Help Desk duhet të jetë i kontaktueshëm nga stafi i Identitek 24/7.

Argumentim: Me anë të kësaj deklarate synohet që shërbimi Help Desk duhet të ofrohet 24/7 dhe me qëllim që fituesi i procedurës së prokurimit gjatë kësaj periudhe të garantojë për autoritetin kontraktor të përfshirë në këtë procedurë marrjen e shërbimit në kohe në raste problematikash apo emergjencash në lidhje me shërbimin e ofruar sa herë të lind nevoja.

Kriteret e teknike të percaktuara sipas pikës 2, 3 dhe 4 të “Kapacitetit Teknik” janë hartuar nga Z. Endri Vangjel, në cilësinë e specialistit të fushës në njësinë e prokurimit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 13/08/2025 Ora: 11:00.